

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		08/06/2026	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
06-	400/01-	21527	



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KOMUNA E DRENASIT**  
**DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE**



Në vështrim të nenit 68 paragrafi 3 të Ligjit nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 3 dhe 17 të Ligjit nr.10/L-022 Për Banim Social dhe të Përballueshëm, Udhëzimit administrativ Nr.19/2010 për përmbajtjen e bonusit të banimit si dhe Programit Komunal Tre Vjeçar për Banim me Nr. 01/400/01-45971 dt.12.09.2023, Vendimt të Kuvendit Komunal Nr. 02-400/01-185720 dt. 30.04.2026, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për gjithë personat fizik dhe juridik të Komunës së Drenasit shpall këtë:

**THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM PËR DHËNIEN ME QIRA TË  
NJËSISË BANESORE, PËR FAMILJET QË PËRFITOJNË NGA BONUS  
BANIMI**

Ftohen të gjithë personat fizik dhe juridik të cilët në pronësinë e tyre kanë njësi banesore të lira dhe mund të aplikojnë për dhënie në shfrytëzim të këtyre banesave me qira, bazuar në Programin e Banimit të Përkohshëm Social, për familjet që vlerësohen të domosdoshme për aplikimin e BONUS BANIMIT.

**Objektet banesore të dedikuara për Bonus Banim, duhet t'i plotësojnë këto norma të banimit:**

1. Banesa duhet të ketë së paku një dhomë, sipërfaqja e banesës nuk mund të jetë më pak se 32 m<sup>2</sup>,
2. Në banesat me dy dhoma, sipërfaqja e banesës nuk duhet të jetë më e vogël se 48 m<sup>2</sup>,
3. Në banesë me tri dhoma, sipërfaqja e banesës nuk duhet të jetë më e vogël se 66 m<sup>2</sup>.

**Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për dhënie me qira të njësisë banesore, përfshijnë:**

1. Aplikacioni ( të dhënat e hollësishme )
2. Dokumenti identifikues;
3. Fleta Poseduese ( Çertifikata e Pronës) dhe kopja e planit;
4. Adresa e banesës që jepet me qira (të shënohet në aplikacion )
5. Numri i xhirrollogarisë bankare;

**Kohëzgjatja e marrëveshjes do të jetë një vjeqare, me mundësi rishqyrtimi qdo vit kalendarik nga organi kompetent komunal. Marrëdhëniet në mes të pronarit të banesës dhe përfituesit të bonusit rregullohen me kontratë.**

**Niveli maksimal i qirasë** nuk duhet të kalojë shumë prej 200 Euro, ndërsa vlera e bonusit të banimit nuk mund të jetë më e madhe se pesëdhjetë përqind (50%) e qirasë minimale të banesave në tregun e lirë për komunën tonë.

Bonusi i Banimit jepet nga komisioni i caktuar për qështje të Banimit të Përkohshëm Social, ndërsa lidhja e kontratës bëhet në mes të personit fizik apo juridik, përkatësisht pronarit të njesisë banesore që jepet me qira dhe bartësit të së drejtës së banimit, përkatësisht qiramarrësit, përmes organit kompetent komunal.

**Mënyra e pagesës së bonusit:**

Shuma mujore e bonusit të banimit paguhet nga buxheti komunal në xhirollogarinë bankare të qiradhënësit ( 100 Euro, apo 50% e nivelit maksimal të qirasë së lartëpërmendur).

Në rast të mospagesës së pjesës së qirasë nga ana e qiramarrësit, qiradhënësi është i detyruar t'ia kthej komunës pjesën e paguar të qirasë së pashfrytëzuar në rast të zgjedhjes së kontratës si pasojë e mospagesës së pjesës së qirasë nga ana e qiramarrësit.

**Marrja e aplikacioneve** mund të bëhet në ndërtesën e Komunës kati I në Qendren për Shërbime me Qytetar nr. 11, 12 dhe dorëzohen në të njëjtën Zyre.

Aplikacionet e dorzuara pas afatit të përcaktuar nuk do të shqyrtohen.

**Afati për aplikim** është 15 ditë pune, nga data 08.06.2026 deri me datë 26.06.2025

Pas përfundimit të afatit (prej 15 ditësh), Komisioni bënë vlerësimin dhe shqyrtimin e aplikacioneve si dhe shpall listën përfundimtare të përfituesve.



**KRYETARI I KOMUNËS**

  
**RAMIZ LLADROVCI**